

Komuna e Prizrenit/Prizren

Muharrem (Fuat) Minushi

(1953, rom nga Prizreni/Prizren, kovaç, tre fëmijë)

Muharremi jetonte në **Prizren**, në Rrugën *Tane Askarajic* në *Terzi Mëhallë/Mahala krojača*, në bashkësi familjare me bashkëshorten Shpresen, fëmijët dhe të vëllain Rexhepin. Në ditën e pacaktuar, në muajin **maj të vitit 1998**, Muharremi doli herët nga shtëpia. Shkoi te shtëpia e djalit të hallës Dautit, dhe e ftoi që të shkonin deri te kafeneja, në afërsi të *Tyrbes Karabeshi/Turbe Karabeshi*, për një gotë raki të mëngjesit. Por, ndenjën atje më shumë se planifikonin, sepse u dehën. Pas një kohe, në kafene erdhën dy shqiptarë [emri i njërit nga ta është i njohur për FDH]. Njëri prej tyre ka qenë pjesëtar i UÇK-së. Kur vuri re se njëri nga ta e mbante shpatën me vete, Muharremi i tha Dautit që menjëherë të shkonte në shtëpi. Dauti iku me vrap. U bëri të ditur burrave në mëhallë dhe familjarëve se Muharremi ishte në rrezik. Vëllezërit e Muharremit, Aliu dhe Rexhepi, nga ora 17:00, shkuan me vrap deri te *Tyrbja Karabeshi/Turbe Karabeshi*, në afërsi të varrezave të romëve. Atje, në rrugë, e gjetën trupin e pajetë dhe të deformuar të Muharremit. Policia e ka kryer hetimin në vendngjarje dhe, më pas, e ka çuar trupin në morg, nga ky familjarët e morën ditën e nesërme. Trupin e Muharremit e kanë varrosur në varrezat e romëve në Prizren.

Burimet: deklarata A.M, FDH-35614; deklarata D.Đ, FDH-4605.

Muhamed (Redžep) Šope

(27.01.1959, rom nga Prizreni/Prizren, i papunë, tre fëmijë)

Muhamedi dhe familjarët e tij jetonin në lagjen e romëve, në Prizren. Merrej me boks, ndërkaq, në fund të karrierës, u bë anëtar i Bordit të Klubit të Boksit *Prizren*. Në pasditen e datës **21.05.1998**, Muhamedi u nis me makinë drejt qytetit. Për herë të fundit e kishin parë nga ora 21:00, në afërsi të pikës së karburanteve *Beopetrol* në **Prizren**. Ishte në automobilin e vet të tipit *Mitsubishi Colt*. Shkonte në drejtim të Suharekës/Suva Reka. Një ditë më vonë, trupi i masakruar i Muhamedit, me duar të lidhura, ishte zbuluar pranë rrugës Shtime/Štimlje - Suharekë/Suva Reka, në Duhël/Dulje, te vendi i quajtur *Biraç/Birač*. Pas kryerjes së hetimit në vendngjarje, trupi i tij u transferua në morgun e spitalit të Prizrenit/Prizren. Obduksioni ka gjetur se ai ishte vranë me armë zjarri. E varrosën më 1.07.1998 në Prizren.

Burimet: deklarata S.A, FDH-32542; deklarata Z.Ć, FDH-13457; deklarata D.M, FDH-13458; deklarata I.B, FDH-13449; KMDLNJ, *Buletini*, num. 9, tetor-dhjetor 1998, 167, FDH-23857; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; AIS, *Zona...*, 56, FDH-16913; SMIP, *Teroristički...*, III, 51, 923; KKMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832.

Din (Alush) Koleci

(10.10.1945, shqiptar nga Kishaj, komuna Gjinaj [Shqipëri], minator, gjashtë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Dini me vëllain Avniun jetonin në bashkësi familjare. Që të dy i kishin familjet e veta. Dini largohej shpesh nga familja për t'i ndihmuar UÇK-së. Në datën **28.05.1998**, ai me një grup ushtarësh të UÇK-së u nis për të transportuar një ngarkesë